

**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SERENITY” SH.P.K.**

Bazuar në Kushtetutën, Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare” i ndryshuar dhe në ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, e nënshkruara, Znj. Oltiana Nanagjoka, shtetase shqiptare, mbajtëse e ID me numër I16204040G, lindur më 04.12.1981, në Berat dhe banuese në Tirane, dhe Z. Marenglen Myrtollari, shtetas shqiptare, mbajtëse e ID me numër I40925090U, lindur më 25.09.1984, në Korçë dhe banuese në Korçë te cilet janë ortaket e shoqërisë, me vullnet të plotë e të lirë ata nënshkruan Akt Themelimin (të inkorporuar në këtë Statut) me qëllim themelimin e kësaj shoqërie sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

**KREU I**

**EMRI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHËZGJATJA DHE  
KAPITALI THEMELTAR**

**NENI I**

**Emri i Shoqërisë**


1.1. Emri i shoqërisë është **“SERENITY” sh.p.k.**

**NENI II**

**Forma Ligjore**

2.1. Shoqëria **“SERENITY”** (këtu e në vijim referuar si **“Shoqëria”**) është e themeluar dhe organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky Statut dhe ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 **“Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare”**, i ndryshuar.

2.2. Shoqëria do të operojë në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Two handwritten signatures in black ink are visible. The signature on the left appears to be "Oltiana Nanagjoka" and the signature on the right appears to be "Z. Marenglen Myrtollari".

### **Neni III**

#### **Objekti i Veprimtarisë**

3.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: Import dhe tregti per lende te para per ushqim blektorie, produkte te cdo natyre per perdorim ne ndermarrjet blektorale ne mbareshtimin e kafsheve, vecanerisht perzierje te lendeve minerale dhe substancave shtese per perpunimin e dritherave etj,si edhe import dhe tregti te produktive per nderrmarrjet e menaxhimit te mbetjeve urbane. Sherbim montimi i paisjeve dhe mirembajtje e impjanteve teknologjike te cdo lloji qe perdoren ne ferma dhe ndermarrje te sektorit agrar.Import, tregtim dhe shitje e makinerive, paisjeve, linjave dhe mallrave te tjera te ndryshme per blektorine (stallat, thertoret, baxhot, etj) dhe ne fushen e perpunimit te produktive dhe nenproduktive me origjine shtazore. Tregtim i cdo lloj teknologjie, makinerie, paisje apo linje qe eshte ne funksion apo sherben per cdo lloj procesi pune per blektorine dhe bujqesine ne fermat e ndryshme blektorale, ne ndermarrjet e grumbullimit dhe perpunimit te produktive dhe nenproduktive blektorale dhe bujqesore dhe ne cdo lloj ndermarrje tjeter te sektorit buqesor dhe blektoral.Kompania do te ofroje sherbimin e konsulences ne fushen e agrobiznesit.Tregtimi i mallrave te ndryshme industriale, ushqimore,etj.me shumice e pakice.Per realizimin e objektit te saj shoqeria mund gjithashtu te bleje dhe te kryeje cdo lloj operacioni financiar aktiv e pasiv te ndermarre e te zhvilloje cdo lloj aktiviteti industrial,tregtar,te paluajtshem dhe financiar qe konsiderohen te dobishem e te pershtatshem me objektin e saj.Importimin dhe eksportimin, prodhimin, perpunimin, transformimin dhe tregtimin e mallrave dhe paisjeve te ndryshme te konsumit, paisjeve elektronike, materialeve te ndertimit dhe mallrave ushqimore. Konsulence Financiare.

3.2. Shoqëria mund të ndërmarrë dhe kryejë edhe aktivitete të tjera, të cilat nuk janë të parashikuara në pikën 1 të nenit 3, por që janë të nevojshme dhe të domosdoshme në përpmbushjen e objektit të veprimtarisë.

### **NENI IV**

#### **Selia e shoqërisë**

4.1. Selia e shoqërisë është në adresën :Njesia Bashkiake nr.2, zona kadastrale 8150,nr pasurie 3/6, Ruga “Qemal Stafa”, nr 232, Tirane.

4.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është [o.nanagjoka@gmail.com](mailto:o.nanagjoka@gmail.com).

4.2. Vendimi dhe angazhimi për transferimin e selisë së shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme (Ortak i vetëm).

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Nanagjoka", is positioned at the bottom right of the page. A small number "2" is located at the top right corner of the signature area.

4.3. Çelja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit në qytete të tjera ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm).

**NENI V**

**Kohëzgjatja**

5.1. Shoqëria do të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar.

**NENI VI**

**Kapitali Themeltar**

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 Lekë.

6.2. Numri total i kuotave është 2, pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

i) Znj. Oltiana Nanagjoka, zoterusi i 1 (nje) kuote ne vlore 50.000(pesedhjete) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

ii) Z. Marenglen Myrtollari, zoterusi i 1 (nje) kuote ne vlore 50.000(pesedhjete) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

6.3. Ortaku i vetëm mund të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë Kapitalin Themeltar në cdo moment, të konsideruar i nevojshëm për të realizuar qëllimin e themelimit të shoqërisë.

6.4. Procedura për zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit themeltar do të rregullohen me vendim të Ortakut të vetëm rast pas rasti.

6.5. Kuota mund të shitet, dhurohet ose transferohet palëve të treta nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm).

6.6 Kontributet e kapitalit te shoqerise mund te jene me para ose ne natyre.

**KREU II**



## **ORGANET E SHOQËRISË**

### **NENI VII**

#### **Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm)**

7.1. Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara në këtë Statut dhe në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare do të kryhen nga Ortaku i Vetëm.

7.2. Asambleja e Përgjithshme është kompetente të vendosë mbi çështjet e mëposhtme:

7.2.i. Amendimet dhe Shtesat e Statutit të shoqërisë

7.2.ii. Zmadhimin dhe/ose Zvogëlimin e kapitalit themeltar;

7.2.iii. Blerjen, Bashkimin, Shkrirjen, Transformimin dhe procesin e Likuidimit të shoqërisë;

7.2.iv. Emërimin dhe Shkarkimin e Administratorit

7.2.v. Emërimin dhe Shkarkimin e Kontabilistëve të Certifikuar

7.2.vi. Miratimin e Pasqyrave Financiare pas verifikimit nga Kontabilisti i certifikuar.

7.2.vii. Emetimi i kuotave

7.2. viii. Emërimi i Likuiduesve në rast të proces likuidimi përvec rasteve të falimentimit

7.2.ix. Përcaktimin e pagës, bonuseve si dhe kohëzgjatjen e emëritit të Administratorit.

7.2.x. Çështje të tjera në ngarkim të Asamblesë nga ligji dhe Statuti.

### **NENI VIII**

#### **Administratori**

8.1. Administrator i shoqërisë “SERENITY” sh.p.k. emërohet Znj. Oltiana Nanagjoka për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, duke filluar nga dita e regjistrimit, me të drejtë rizgjedhje.

8.2. Administratori është përgjegjës për:

8.2.i. Manaxhimin e veprimtarisë së biznesit me implementimin e politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;

8.2.ii. Prezantimin e shoqërisë përpara palëve të treta;



- 8.2.iii. Mbikqyrjen e mbajtjes së Librave të Kontabilitetit dhe dokumenteve te tjera të nevojshme;
- 8.2.iv. Përgatitjen dhe nënshkrimin e Pasqyrave Financiare, Llogarive të Konsoliduara dhe raportin vjetor të përformancës së shoqërisë. Paraqitjen e dokumenteve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimin e shpërndarjen e fitimeve;
- 8.2. v. Krijimin e një sistemi paralajmërues për zhvillimet që mund të cënojnë shoqërinë;
- 8.2. vi. Raportimin në Asamblenë e Përgjithshme mbi implementimin e politikave të të bërit biznes dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të vecantë për performancën e shoqërisë;
- 8.2. vii. Kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji ose Statuti;
- 8.3. Administratori mund të autorizojë palë të treta për kryerjen e veprimeve të ndryshme, të tilla si: depozitim i Pasqyrave Financiare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përfaqësimin e shoqërisë përpara institucioneve shtetërore, etj., përvèç rasteve të parashikuara si kompetencë eksklusive e Administratorit nga ligji ose ky Statut.

### KREU III

#### MBARIMI, LIKUIDIMI, TË NDRYSHME

### NENI IX

#### Përfundimi i shoqërisë

9.1. Shoqëria mbaron:

9.1.a me vendim të Asamlesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm);

9.1.b me çeljen e procedurës së falimentimit;

9.1.c nëse nuk ka kryer veprimitari biznesi për 2 (dy) vjet dhe nuk ka njoftuar më parë statusin inaktiv sipas ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”; ose

9.1.c me vendim gjyqësor.

9.2. Adiminstratori ose cdo person i autorizuar prej tij do të depozitojë raportin e shpërbërjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.



5

## **NENI X**

### **Likuidimi**

10.1. Pas vendimit për mbarimin e shoqërisë, do të hapet procedura e likuidimit, përvèc rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.

10.2. Për kryerjen e procesit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) ose disa likuidues, për qëllim hartimin e raportit të aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë, deri në mbarim të procesit të likuidimit.

10.3. Procesi i likuidimit do të bëhet në përputhje me ligjin 9901 “*Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare*”, i ndryshuar.

10.4. Pas pagesës së likuiduesve, kapitali i mbetur i shoqërisë do t'i shpërndahet Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm).

## **NENI XI**

### **Viti financiar**

11.1. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Përjashtimisht, viti i plotë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më 31 dhjetor.

## **NENI XII**

### **Të ndryshme**

12.1. Të gjitha situatat që nuk parashikohen nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare*”, i ndryshuar.

12.2. Të gjithë dokumentet për palët e treta, të tillë si njoftime, publikime, dhe faturime etj., do të pëfshijnë emrin e shoqërisë së bashku me shkurtimet “sh.p.k.”, selinë, emrin e administratorit ose të të autorizuarit prej tij.



6

12.3. Bazuar në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në Regjistrin e mbajtur për këtë qëllim.


12.4. Ky statut është i draftuar në 3 (tre) kopje originale me fuqi të njëjtë juridike.

### **ORTAKET E SHOQËRISË**

**SERENITY Sh.P.K.**

Znj. Oltiana Nanagjoka

Z. Marenglen Myrtollari



12.07.2021